



THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË AKADEMI PËR LIDERE DHE LIDER TË RINJ

Instituti Nacional Demokratik (NDI) në kuadër të projektit **Gratë dhe burrat udhëheqin, me qëllim të avancimit të barazisë gjinore** të financuar nga Agjencioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtarë (SIDA), shpall thirrje për pjesëmarrje në **Akademinë për lidere dhe lider të rinj**.

Nëpërmjet pjesëmarrjes në akademi, pjesëmarrësit pritet që të:

- **Mësojnë** se si të jenë lider më efektivë,
- **Forcojnë** aftësitë e tyre negociuese dhe komunikuese,
- **Zhvillojnë** aftësitë e tyre për zhvillimin e politikave,
- **Avancojnë** ndjeshmërinë e tyre gjinore,
- **Lidhen** me njëri-tjetrin, dhe
- **Fitojnë vetëbesim** për të qenë promovues aktivë për barazi më të madhe gjinore dhe përfshirje në jetën politike

Akademia për leadership do të përfshijë rreth 50 studentë dhe studente nga studimet juridike, shkencat politike dhe studimet gjinore nga Universiteti “Sh. Kirili dhe Metodi, Universiteti Sh. Kliment Ohridski, Universiteti “Fadil Sulejmani” dhe Universiteti “Goce Dellçev”, të cilët kanë interes për politikë dhe pjesëmarrje politike. Në akademi mund të paraqiten studentët ne studime deridiplomike, studime master dhe studime të doktoratës.

Për pjesëmarrje në akademi, pjesëmarrësit e kualifikuar duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Të jenë student në një nga fakultetet e përmendura në këtë thirrje,
- Të kenë interes për politikë, udhëheqjen politike dhe përfshirjen në jetën publike,
- Të mos jenë anëtarë të ndonjë partie politike,
- Të njohin mirë gjuhën angleze,
- Të jenë të moshës 20-29 vjeçare dhe
- Të kenë mbështetjen për pjesëmarrje nga fakulteti i tyre.

Të gjithë pjesëmarrësit e interesuar mund të paraqesin interesimin e tyre duke plotësuar fletëparaqitjen e cila duhet të dërgohet në adresën **ndimacedonia@ndi.org** jo më vonë se **21 shkurt 2022**. Fletëparaqitja duhet të plotësohet në gjuhën angleze dhe e njejta mund të shkarkohet këtu: [INSERT LINK].

Përzgjedhja e studentëve që do të marrin pjesë në akademi do të bëhet nga NDI në bashkëpunim me fakultetin përkatës.

Qëllimi kryesor i akademisë është të forcojë njohuritë dhe aftësitë udhëheqëse tek të rinjtë dhe t'i motivojë ata që të përfshihen në mënyrë më aktive në krijimin e politikave por edhe të japin kontribut aktiv në përmirësimin e barazisë gjinore në vend.

Akademia do të zbatohet gjatë vitit 2022. NDI do të organizojë tre punëtori që do të fokusohen në temat në vijim: aftësitë drejtuese, komunikimi efektiv, zhvillimi dhe komunikimi i mesazheve, marrëdhëniet me mediat, përfshirje në proceset e vendimmarrjes dhe zhvillimit të politikave, të menduarit strategjik për negociata dhe debate, aftësitë e menaxhimit organizativ dhe të ngjashme.

Në kuadër të akademisë, do të respektohen masat e parapara për mbrojtje nga pandemia me Covid-19.

NDI është e përkushtuar që diversiteti, drejtësia dhe përfshirja të reflektohen në të gjitha aspektet e punës së institutit, përfshirë edhe në zbatimin dhe realizimin e kësaj akademie. NDI do të veprojë në mënyrë proaktive të sigurojë diversitet dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrje midis pjesëmarrësve, pa dallim nëse ata janë pjesëmarrës, folës, panelistë ose të përfshirë në një detyrë apo rol tjetër.

Për më shumë informata rreth akademisë dhe kushteve për pjesëmarrje mund të kontaktoni NDI në ndimacedonia@ndi.org.